

DIPLOMIMI NË GJIMNAZIN “LOYOLA-GYMNASIUM”



Provimi u organizua nga Ministria e Kulturës e Republikës Federale të Gjermanisë në bashkëpunim me ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë dhe përmban në vete katër kompetenca gjuhësore: të kuptuarit e leximit, të dëgjimit, kompetenca në të shkruar dhe në të folur

Prizren

Të shtunën më datën 18.05.2013 në gjimnazin Loyola në Prizren diplomoi gjenerata e pestë me radhë në lëndën e gjuhës gjermane.

Provimi u organizua nga Ministria e Kulturës e Republikës Federale të Gjermanisë në bashkëpunim me ambasadën e Gjermanisë në Prishtinë dhe përmban në vete katër kompetenca gjuhësore: të kuptuarit e leximit, të dëgjimit, kompetenca në të shkruar dhe në të folur.

Nxënësit, të cilët e kanë kaluar këtë provim, kanë tashmë të plotësuar kushtin kryesor për studime në vendet gjermanofolëse. Ndarjen e diplomave të gjuhës gjermane e bëri udhëheqësja e dikasterit të shtypit dhe kulturës pranë ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, zonja Milena

Tutsch. Dy nga nxënësit më të mirë të shkollës përfituan po ashtu bursa për studime në Gjermani.

Bursa është e plotë dhe si e tillë i mbulon të gjitha shpenzimet e studimeve në Gjermani, duke i përfshirë shpenzimet e fakultetit dhe ato jetësore atje. Kjo bursë u nda për gjithsejtë 140 nxënës në tërë botën dhe nga gjithë ata dy ishin nga shteti dhe shkolla jonë, dhe kjo tregon më së miri inteligjencën e nxënësve dhe punën e mirë që është bërë me ta në këtë shkollë. **(Neki Jahaj)**